




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



STATUTI  
I  
AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Prishtine, 2022



---

## Përmbajtja

1. Statuti.....	3
2. Misioni i NJAB.....	3
3. Misioni I Njesisë Së Auditimit Të Brendshëm.....	3
4. Parimet e funksionit të auditimit të brendshëm.....	3
5. Fushëveprimi i punës së NJAB.....	4
6. Të drejtat e Njesisë së auditimit të brendshëm.....	4
7. Përgjegjësia e Udhëheqësit te Njesisë se Auditimit te Brendshëm.....	4
8. Marrëdhënia e Njësia e Auditimit të Brendshëm me KA.....	5
9. Bashkëpunimi e Njësia e Auditimit të Brendshëm me NJQHAB.....	5
10. Programi i Auditimit.....	6
11. Raporti i Auditimit dhe Rekomandimet .....	6
12. Koordinimi me Zyrën Kombëtare te Auditimit.....	7
13. Llogaridhënia.....	7
14. Pavarësia.....	8
15. Standardet e Praktikës së Auditimit të Brendshëm.....	8

---

Neni 1  
**Statuti**

Statuti përfshin misionin, fushëveprimin, autoritetin dhe përgjegjësitë e funksionimit të Auditimit të Brendshëm (AB) në Njësinë e Auditimit Të Brendshëm (DAB) në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Statuti përfshinë disa përgjegjësi të përgjithshme të Auditimit të Brendshëm, të cilat janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-021 Për Kontrollin e Brendshme të Financave Publike në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimit QRK- Nr 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik.

Neni 2  
**Misioni**

Misioni i Auditimit të Brendshëm është të ofroj siguri të pavarur dhe objektive për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe ofroj këshilla për përmirësimin e tij.

Shërbimi i sigurisë është shqyrtim objektiv i dëshmisë me qëllim të ofrimit të vlerësimit të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit të subjektit të sektorit publik.

Neni 3  
**Misioni i Njësisë së Auditimit të Brendshëm**

Misioni i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është të ofroj shërbimet të pavarura, objektive, siguroese dhe këshillëdhënëse të dizajnuara që të shtojnë vlerën dhe të përmirësojnë punën në organizatë.

Ndihmon organizatës që të arrij objektivat e saja duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Neni 4  
**Parimet e funksionit të auditimit të brendshëm**

Auditimi i brendshëm në sektorin publik ushtrohet bazuar në standardet e auditimit të brendshëm, kodin e etikës, metodologjinë e miratuar nga Ministri i Financave dhe në pajtueshmëri me parimet, si në vijim:

1. Ligjshmërinë;
  2. pa anshmërinë dhe integritetin;
  3. pavarësinë dhe objektivitetin;
  4. profesionalizmin dhe kujdesin e duhur profesional; dhe
  5. kompetencën dhe konfidencialitetin.
- 

*nk*

---

Neni 5

**Fushëveprimi i punës të Njesisë së Auditimit të Brendshëm**

Fushëveprimi i punës të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, është që të përcaktoj nëse KGJK-ja për proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes siç është dizajnuar dhe përfaqësuar nga menaxhmenti, është adekuat dhe funksionon në atë mënyrë që të siguroj që:

- Rreziqet të identifikohen dhe menaxhohen si duhet;
- Ndërveprimi me grupet e ndryshme të qeverisjes të ndodhë sipas nevojës;
- Informata të mjaftueshme financiare, menaxheriale dhe operative të janë të sakta, të besueshme dhe me kohë;
- Veprimet e punonjësve të janë në pajtueshmëri me politikat, standardet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e aplikueshme;
- Burimet të sigurohen në mënyrë ekonomike, të përdoren me efikasitet dhe të mbrohen në mënyrë adekuate;
- Të arrihen programet, planet dhe objektivat;
- Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm të promovohen në procesin e kontrollit të organizatës dhe
- Çështjet e rëndësishme legislative ose rregullatorë që kanë ndikim në organizatë të janë pranuar dhe adresuar si duhet.

Fushëveprimi i punës të Njesisë së Auditimit të Brendshëm përkatësisht Auditori i Brendshëm ka fushëveprim edhe në:

- Rishikimin e proceseve përfshi të gjitha departamentet, zyrat në SKGJK-ë dhe të gjitha gjykatat duke filluar nga Gjykata Supreme, Apelit dhe Themeloret me dege brenda Gjyqësorit në interval të përshtatshëm kohore për të përcaktuar nëse ato në mënyrë efikase dhe efektive janë duke kryer funksionet e tyre të planifikimit, organizimit, drejtimit dhe kontrollimit në pajtim me kornizën ligjore të KGJK-së ,
- Rishikimin/vlerësimin e operacioneve dhe programeve për të konstatuar nëse objektivat dhe qëllimet janë përputhje me rezultatet e arritura nga operacionet dhe programet sipas planifikimit,
- Koordinimin e aktiviteteve tjera jashtë KGJK-ë përfshin NJQHAB në MF, ZKA dhe institucionet tjera relevante që ofrojnë shërbim sigurie dhe këshilluese,
- Përgatit, azhurnon dhe përcjell të Komitetit të Auditimit planet vjetore për shqyrtim dhe miratim,
- Përcjell zbatimin e rekomandimeve të auditimit për të siguruar nëse është bërë implementimi i rekomandimeve nga menaxhmenti i KGJK-së.

Neni 6

**Të drejtat e Njesisë së Auditimit të Brendshëm**

Drejtori i njesisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm kanë të drejtë:

---

- 
- në qasje të lirë te menaxhmenti, anëtarët e personelit dhe pasuritë e subjektit të sektorit publik, që kanë të bëjnë me kryerjen e auditimit;
  - në qasje të lirë në të gjitha informatat, përfshirë ato të klasifikuara sipas nivelit të tyre të qasjes së lejuar, qasje në sistemet e teknologjisë informative, të gjitha dokumentet dhe të dhënat në dispozicion, përfshirë edhe ato elektronike, që janë të domosdoshme për kryerjen e auditimit; dhe
  - të kërkojnë nga zyrtarët përgjegjës çfarëdo të dhëna, pasqyra përmbledhëse, opinione, konfirmime, dokumente dhe informata tjera të nevojshme, në lidhje me detyrën e auditimit

Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm nuk kanë të drejtë:

- Kryejnë ndonjë detyrë operative për organizatën ose partnerët e saj;
- Iniciojnë ose miratojnë transaksionet e kontabilitetit që i nënshtrohen auditimit;
- Drejtojnë aktivitetet e punonjësve të KGJK që nuk janë pjesë e NjAB-it, përveç deri në atë shkallë kur punonjësit e tillë janë caktuar në ekipet e auditimit si duhet, ose në ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar auditorët e brendshëm.

#### Neni 7

#### **Përgjegjësia e Udhëheqësit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm**

Drejtori i NjAB-it ka përgjegjësinë që të:

- Hartojë Planin Strategjik dhe Vjetor të auditimit të brendshëm duke përdorur metodologjinë adekuate që bazohet në rrezik përfshirë çfarëdo shqetësimi për rrezik ose kontroll të identifikuar nga menaxhmenti;
  - Zbatoj Planin Vjetor të auditimit që është miratuar, përfshirë edhe ndonjë detyrë ose projekt special që është i përshtatshëm e që kërkohet nga menaxhmenti dhe Komiteti i Auditimit;
  - Monitoron dhe mbikëqyrë stafin i cili është i përfshirë në NjAB;
  - Ketë personel profesional të auditimit me njohuri të duhur , shkathtësi, përvojë dhe të certifikuar për të përmbushur kërkesat e këtij Statuti;
  - Themeloj programin e sigurimit të cilësisë me anë të së cilit siguron funksionimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm;
  - Kryej shërbime këshillëdhënëse përtej shërbimeve të auditimit të brendshëm për siguri, të asistoj menaxhmentin në arritjen e objektivave të tij. Shembujt mund të përfshijnë lehtësimin, disenjimin e procesit, trajnimin dhe shërbimet këshillëdhënëse;
  - Vlerësoj dhe caktoj funksionet e rëndësishme, shërbimet, proceset, operacionet dhe risitë në proceset e kontrollit që janë në ndryshim e sipër që ndërlidhen me zhvillimet, zbatimin dhe shtrirjen e tyre;
  - Përgatitë dhe merr pjesë në seancat e Komitetit të Auditimit dhe raporton tek menaxhmenti duke përmbledhur rezultatet e aktiviteteve të auditimit;
  - Ofroj një listë të synimeve të matjes së rezultateve të rëndësishme për komitetin e auditimit;
-



---

## Neni 8

### Marrëdhënia e Njësisë së Auditimit të Brendshëm me Komitetin e Auditimit

Komiteti i Auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.

Komiteti i Auditimit mbështetë llogaridhënien përmes:

- sigurimit dhe mbikëqyrjes së pavarur të planeve dhe rezultateve të auditimit të brendshëm;
- të gjeturave dhe rekomandimeve që pranohen nga KGJK sipas veprimit të tyre;
- dhënies së këshillave në lidhje me atë se sa është i përshtatshëm funksionimi i sistemit të kontrollit për menaxhmentin.

NjAB-i mbështet KA-në duke punuar me komitetin në këto çështje:

- NjAB-i përpilon Planin Strategjik dhe Vjetor të cilin pas shqyrtimit e aprovon Komiteti i Auditimit;
- Rishikimin e linjave raportuese funksionale, administrative të NjAB-it në kuadër të KGJK për të siguruar se mirëmbahet pavarësia e tyre;
- Vlerësimin e përshtatshëm të personelit, përshtatshmërinë financiare dhe burimet tjera në dispozicion për NjAB;
- Sigurimin se nuk bëhet asnjë kufizim i burimeve apo fushëveprimit që do të pengonte aktivitetet e auditimit të brendshëm;
- Sigurimin e raporteve të cilat përmbledhin aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe drejtimin e vëmendjes së komitetit në dobësitë e sistemeve, rreziqeve dhe parregullsive operacionale;
- Raportimin me kohë të aktiviteteve joligjore, mashtruese apo korruptuese;
- Të kërkoj ose lejoj NjAB ose auditorin e brendshëm që të bëjë vlerësimin e masave të ndërmarra nga KGJK për zbatimin e rekomandimeve të bëra në mosrespektimin e procedurave ligjore, sistemin e menaxhimit të kontrollit dhe përmirësimin e sistemeve;
- Të siguroj se menaxhmenti dhe personeli i KGJK ndërmarrin masa për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB;

Komunikimi efektiv në mes të NjAB-it dhe Komitetit të Auditimit është me rëndësi për KGJK.

Komunikimet kyçe janë në këto aktivitete:

- Takimet në mes të Drejtorit të NjAB-it dhe Komitetit të Auditimit ;
- Raportet përmbledhëse periodike të aktiviteteve të auditimit të brendshëm;
- Raporti vjetor për aktivitetet e auditimit të brendshëm;

---

Neni 9

**Bashkëpunimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm me Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit Të Brendshëm**

Bashkëpunimi i NjAB-it me Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm qëndron në:

- Zbatimin e rregullave, politikave, doracakëve , udhëzimeve dhe standardeve për funksionimin e auditimit të brendshëm, që rregullojnë fushën e auditimit të brendshëm të përgatitura nga NJQHAB;
- NjAB-i për çdo vit fiskal përgatit dhe ia paraqet planin strategjik dhe vjetor NJQHAB-së;
- Edukimin e vazhdueshëm profesional.

Neni 10

**Programi i Auditimit**

Plani strategjik afatgjatë ofron rishikimin e aktiviteteve të rëndësishme të KGJK që bazohen në vlerësime të rrezikut që ndërliken me arritjen e objektivave të KGJK.

Plani vjetor në përputhje me planin strategjik të auditimit të brendshëm për vitin e ardhshëm duhet të përgatitet para fillimit të çdo viti fiskal.

Neni 11

**Raporti i Auditimit dhe Rekomandimet**

Raportet e shkruara do të përgatiten dhe lëshohen nga auditorët e brendshëm për menaxhmentin e lartë në përfundim të çdo auditimi.

Raportet e auditimit duhet të sqarojnë fushëveprimin dhe objektivat e auditimit, të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet.

Pas lëshimit të draft raportit, menaxhmenti i lartë është i obliguar që brenda afatit të caktuar kohor ta përmbyllë takimin për dhënien e komenteve.

Pas këtij afati, auditori ka të drejtë ta finalizoj draft raportin e auditimit perkates.

Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve është përgjegjësi ekskluzive e menaxhmentit.

---

---

Neni 12

**Koordinimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Njësia e Auditimit të Brendshëm i KGJK do të koordinoj punën me ZKA, në:

- kujdesin e marrëdhënieve bashkëpunuese për shkëmbimin e informatave;
- reduktimin e dyfishimit të punës së auditimeve;
- sigurimin dhe ndarjen e duhur të informacionit ;
- sigurimin, koordinimin e të gjitha arritjeve të përgjithshme të auditimit.

Bashkëpunimi i NjAB-it me ZKA do të realizohet përmes ofrimit të letrave të punës së auditimit të brendshëm, programeve, diagrameve dhe raporteve.

Neni 13

**Llogaridhënia**

Drejtori i Njesisë së Auditimit, në kryerjen e detyrave të tij/saj do të jetë përgjegjës ndaj menaxhmentit që të:

- Ofroj për çdo vit vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e proceseve të organizatës për kontrollimin e aktiviteteve të saja dhe menaxhimin e rreziqeve të saja në fushat e vënë nën misionin dhe fushëveprimin e punës;
- Të raportoj çështjet e rëndësishme që ndërlidhen me proceset për kontrollimin e aktiviteteve të organizatës dhe partnerëve të saj, përfshirë edhe përmirësimet potenciale të atyre proceseve dhe ofrimin e informatave për sa i përket çështjeve të tilla nëpërmjet të zgjidhjeve;
- Ofroj periodikisht informatat mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor të auditimit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të departamentit dhe
- Koordinoj dhe mbikëqyrë funksionet e tjera të kontrollit dhe ato monitoruese (menaxhimin e rrezikut, pajtueshmërinë, sigurinë, ligjshmërinë, etikën, mjedisin, auditimin e jashtëm).

Neni 14

**Pavarësia**

Njësia e auditimit të brendshëm ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt vetëm udhëheqësit të subjektit të sektorit publik dhe e njofton Komitetin e Auditimit.

Për t'i dhënë pavarësi Njesisë së Auditimit të Brendshëm, personeli i tij i raporton Drejtorit të Njesisë së Auditimit , i cili/a administrativisht i raporton Zyrtarit Kryesor Administrative dhe Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Si pjesë e raportimit të tij/saj tek Komitetet e Auditimit do të përfshijë edhe një raport të rregullt mbi personelin e auditimit të brendshëm.

---



---

Neni 15

**Standardet e Praktikës së Auditimit Të Brendshëm**

Njësia e Auditimit të Brendshëm do të jenë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të brendshëm të Institutit të Auditorëve të Brendshëm ose tejkaloj Standardet e paraqitura të auditimit të brendshëm .

Neni 16

**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrje në fuqi të këtij Statuti në datën e nënshkrimit, shfuqizohet Statuti paraprak i miratuar për Auditimin e Brendshëm.

Neni 17

**Hyrja në fuqi**


Ky Statut hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kryesuesi i Komitetit të auditimit të brendshëm.

Kadifete Daka



Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Albert ZOGAJ



Kryesues i KGJK-së

Nysret Koca



25/05/2022

Kryesuesi i Komitetit të Auditimit

---

---